



**REPUBLIKA E KOSOVËS /
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO**

C.nr.182/12

GJYKATA KOMUNALE NË PRIZREN, me gjyqtaren Shpresa Emra, çështjen juridike të paditësve A. B. dhe E. L. të dyja nga Prizreni, të cilat i përfaqëson i autorizuari i tyre av. Z. I. nga Prishtina, kundër të paditurës Kompania e sigurimeve "I." nga Prishtina të cilën e përfaqëson F. A., për kompensim dëmi, për kompensim të dëmit, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik, me dt.26.11.2012 mori:

A K T G J Y K I M

I. PJESËRISHT APROVOHET kërkesëpadia e paditëseve A. P. dhe E. L., nga Prizreni, obligohet e paditura KS "I." nga Prishtina, që paditëseve t' i paguaj :

Për paditësen A. P. në emër të dëmit jomaterial

-në emër të dhimbjeve fizike të të gjitha kategorive shumën.....	3.500€
-në emër të frikës të të gjitha kategorive shumën prej	1.000€
-në emër të zvoglimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor 30% shumën.....	5.000€
-në emër të shëmtimit trupor shumën prej.....	1.000€
Për dëmin material shumën prej	220€
Gjithsejt shuma prej.....	10.720€

Për paditësen E. L. në emër të dëmit jomaterial

-në emër të dhimbjeve fizike të të gjitha kategorive shumën.....	650€
-në emër të frikës të të gjitha kategorive shumën prej	1.000€
-në emër të zvoglimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor 30% shumën.....	1.000€
Gjithsejt shuma prej.....	2.650€

Në shumë të tërësishme për të dy paditëset prej 13.370 € me kamatë ligjore në këtë shumë, e cila fillon të rrjedhë nga dita e marrjes së aktgjykimit, gjer më pagesën definitive, të gjitha në afat prej 15 ditësh, nga plotfuqishmëria e aktgjykimit, nën kërcënim të ekzekutimit.

II. Pjesa tjetër e kërkesëpadiësë respektivisht dallimi nga shuma e kërkuar prej 16.770€ gjer te shuma aprovar 13.370€ - REFUZOHET SI E PABAZUAR.

III. Obligohet i padituri që paditëve t'i kompensojë shpenzimet e procedurës në shumë prej **2.020 €**, të gjitha në afat prej 15 ditësh, nga plotfuqishmëria e aktgjykimit, nën kërcënim të ekzekutimit.

A r s y e t i m

Paditëset respektivisht i autorizuari i tyre ka parashtruar padi për kompensim dëmi për shkak se ka ndodhur aksidenti në vitin 2005 në rrugën Vërmicë- Prizren në të cilën lëndime trupore kanë pësuar A. P., E. L., M. R. dhe Sh. K. të gjithë nga Prizreni. Fatkeqësinë e ka shkaktuar ngasësi i automjetit "Mercedes" Sh. K. nga Prizreni i cili në këtë aksident edhe ka humbur jetën. Automjeti me të cilin është shkaktuar aksidenti ka qenë e siguar tek e paditura. Gjatë shqyrtimit i autorizuari i paditëve sa i përket të paditurve M. R. dhe Sh. K. e ka tërhequr padinë. Paditësja A. P. në këtë aksident ka pësuar lëndime të rënda trupore si dhe iu ka zvogluar aktiviteti jetësor i përgjithshëm, ka përjetuar frikë, dhimbje, i është dashur ndihma e personit të tretë si dhe ka pasur shpenzime materiale gjatë shërimit. Për të gjitha këto ka kërkuar dëmshpërblim nga e paditura shumë prej 13.420€. Gjithashtu e paditura E. L. për lëndimet e pësuar në këtë aksident për dhimbje, frikën dhe zvoglimin e aktivitetit jetësor ka kërkuar që t' i kompensohet dëmshpërblimi në shumë prej 3.350 €. Në fjalën e tij të fundit i autorizuari i paditëve ka ngelur në tërësi pranë kërkesë padisë së precizuar me datë 06.11.2006 me përjashtim se ka hequr dorë nga kërkesa sipas pikës 5. dhe 6. për paditësen A. P. dhe për pikën 4. dhe 5. për E. L. ku ka të bëjë me ndihmën e personit të tretë dhe ushqimin e përforcuar. I ka kërkuar shpenzimet sipas precizimit të kërkesë padisë si dhe shpenzimet të bëra pas shqyrtimit mbi revizionin dhe atë për 3 shqyrtime me nga 180 € për shqyrtim dhe për ekspertizën e neuropsikiatrit në shumë prej 100 €.

I autorizuari i të paditësve ka kontestuar në tërësi padinë dhe kërkesë padinë sa i përket lartësisë së dëmit të kërkuar të precizuar me kërkesë padi duke cekur se janë tejet të larta dhe në disproporcion me lëndimet dhe nuk janë konformë kriterit të vlerësimit të cilat i aplikojnë kompanitë e sigurimeve e që janë të nxjerrura nga BKQ-a me theks të veçant sa i përket zvoglimit të aktivitetit jetësor për faktin se eksperti në bazë të përshkrimit që ka bërë konstatoi se kemi të bëjmë me zvoglimin e aktivitetit jetësor të përkoshëm. Në fjalën e tij të fundit ka propozuar që gjykata pas administrimit të provave dhe me rastin e vlerësimit të përgjithshëm të dëmit të bazohet në kriteret e lartcekura dhe përtej këtyre kriterëve ta refuzoj kërkesë padinë e paditësit si të pabazuar. Shpenzimet nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas vlerësimit të provave të administruara, secilës veç e veç dhe të gjitha bashkërisht, në kuptim të nenit 8 të LPC dhe gjeti se kërkesëpadija e paditësve është **PJESËRISHT E BAZUAR**

Për vërtetimin e gjendjes faktike, në këtë çështje juridike, gjykata në procedurën e provave ka administruar provat si vijon e ka lexuar ekspertizën e ekspertit mjeko ligjor Dr. Bujar Kastratin në shqyrtim me datë 20.10.2006, ka lexuar raportin e policisë nga

vendi i ngjarjes nr. 2006-GR-4189 të dt. 23.08.2005 së bashku me skicën, ka bërë shiqimin në policën e sigurimit nr.0000180680 të dt.26.02.2006, ka bërë shiqimin në dokumentacionin mjeksor ka lexuar aktvendimin e PPQ.PP.nr.163/05 të dt. 11.10.2005, ka dëgjuar dhe e ka marr ekspertizën e ekspertit neuro psikiatër Dr.N. F. në shqyrtim me dt. 06.11.2012.

Me leximin e deklaratës dhe dhënjen e mendimit të ekspertit mjeko ligjor Dr. B. K. të cilën e ka dhënë në procesverbal të shqyrtimit kryesor me dt. 20.10.2006 gjykata ka vërtetuar se A. P. ka pësuar lëndim të rëndë trupor të thyerjes së bazës së kafkës nga ana e majtë, gjakderdhje nga veshi dhe paralizën e nervit të fytyrës.Me këtë rast ka pasur dhimbje fizike të intensitetit posaçërisht të rëndë për një orë derisa i është dhënë ndihma e parë në spitalin e Prizrenit kurse më pasë ka pasur edhe dhimbje fizike të intensitetit të lart, të mesëm si dhe të intensitetit të ultë ka edhe sot e kësaj dite.Në këtë aksident për shkak të lëndimeve të marra i është zvogluar aktiviteti i përgjithshëm jetësor për 30% dhe ka shëmtim të shkallës së ultë në fytyrë me pasoja të përhershme. Ka pasur nevojë për ushqim të përforcuar dhe ndihmën e personit të tretë.Sa i përket paditëses E. L. sipas ekspertit të lartcekur e njëjta ka pësuar lëndime të lehta trupore që manifestohen me tronditje të trurit, ndrydhje të pjesës së qafës, ndrydhje të artikulacionit të dorës së djathtë dhe ndrydhje të artikulacionit majtas të këmbës.Me këtë rast ka pasur dhimbje të intensitetit posaçërisht të rëndë për një orë kurse dhimbje të intensitetit të rëndë dhe të mesëm kanë vazhduar dhe ato të intensitetit të ultë ka edhe sot e kësaj dite. Aktiviteti jetësor i është zvogluar për 5% për shkak të dhimbjeve të qafës, mpirjes së duarve dhe pamundësisë së kryerjeve të punëve precize.Shëmtim nuk ka kurse ka pasur nevojë për ushqim të përforcuar dhe ndihmën e personit të tretë.

Me leximin e raportit të policisë nr.2006-GR-4189 të dt. 23.04.2005 është vërtetuar se me këtë datë ka ndodhur aksidenti në rrugën Vërmicë- Prizren në mes të dy automjeteve që të dyja të tipit “Mercedes” automjeti i parë e godet automjetin e dytë nga ana e majtë e mbrojtësit të përparmë dhe pas kësaj e humb kontrollin dhe përplasat në një pemë në anën e djathtë të rrugës. Me këtë rast ngasësi i automjetit e humb jetën kurse 4 bashkëudhëtarët e tij pësojnë lëndime të rënda dhe të lehta trupore. Si bashkëudhëtarë në këtë automjet ishin edhe të dëmtuarat A. P. dhe E. L. Gjithashtu me shiqimin në raportin e policisë është vërtetuar se automjeti ka qenë i siguruar në KS “I.” me nr.0000180680 me datë 25.02.2006 në emër të ngasësit Sh. K.

Me shiqimin në dokumentacionin mjeksor është vërtetuar se A. P. është hospitalizuar në spitalin e Prizrenit në repartin e kirurgjisë me dt. 24.03.08.2005 më pas është transferuar në repartin e ORL dhe është hospitalizuar prej dt. 30.08.2005 gjer më 16.09.2005. Nga blloqet e barnatoreve është vërtetuar se ka pasur shpenzime për blerjen e barërave dhe nga librezat e shëndetësisë është vërtetuar se është mjekuar prej dt. 05.09.2005 gjer më 23.09.2005.

Me leximin e aktvendimit PPQ në Prizren PP.nr. 163/05 të dt. 11.10.2005 është vërtetuar se është hudhur posht kallximi penal i policisë regjionale të trafikut në Prizren

me datë 23.08.2005 të ushtruar ndaj të paraqiturit Sh. K. nga Prizreni, për shkak të veprës penale rreziku i trafikut publik nga neni 297 par. 5 lidhur me par.3 të KPK pasi që i njëjti e ka humbur jetën në këtë aksident e cila rrethan e pamundëson ndjekjen penale. Në arsyetim si përgjegjës për aksidentin e ndodhur përcaktohet ngasësi Sh. K..

Me dëgjimin e ekspertit të neuropsikiatrisë Dr.N. F. nga Prizreni në shqyrtim me datën 06.11.2012 gjykata e ka marr mendimin e tij i cili ka cekur se paditësja A. P. në aksident ka pësuar lëndime trupore të rënda për të cilat edhe ka përjetuar frikë. Frikën primare nuk ka pasur për shkak të lëndimit të trurit dhe humbjes së vetëdijes kurse ka përjetuar frikë sekondare të intensitetit të lart që ka zgjatur 3 ditë e manifestuar me frikën për pasojat e mundshme të lëndimit të pësuar si dhe nga procedurat mjeksore të aplikuara. Gjithashtu ka përjetuar frikë të intensitetit të mesëm dhe të ulët. Sa i përket paditëses E. L. e njëjta gjithashtu frikë primare nuk ka pasur për shkak të humbjes së vetëdijes por ka pësuar frikë sekondare të intensitetit të lart që ka zgjatur dy ditë si dhe frikë të intensitetit të mesëm një javë dhe të intensitetit të ulët një vit.

Në rastin konkret në bazë të provave të lartcekura gjykata konstatoi se nuk është kontestuese dhe është vërtetuar se ka ndodhur aksidenti komunikacionit në bazë të raportit të policisë ku personi përgjegjës i cili e ka shkaktuar aksidentin e ka humbur jetën gjë që është vërtetuar nga aktvendimi i PPQ në Prizren. Gjithashtu nuk është kontestuese se automjeti ka qenë i siguar në kompaninë e cila në rastin tonë është e paditur. Gjkata duke vepruar sipas vërejtjeve të Gjykatës Supreme të Revizionit Rev.I.Nr.507/09 të dt. 12.01.2011 e ka angazhuar ekspertin neuropsikiatër për vlerësimin e dëmit jomaterial të frikës dhe i ka administruar edhe prova të tjera me qëllim të vlerësimit të drejtë të lartësisë së kompensimit të dëmit për lëndimet e pësuar të paditëses së parë e cila ka pasur lëndime të rënda trupore dhe të paditëses së dytë me lëndime të lehta trupore dhe bazuar në atë se baza juridike sipas parimit të përgjegjësisë objektive dhe përgjegjësisë së kontraktuar sipas polisës së sigurimit për dëmin ndaj personave të tretë në kuptim të nenit 178, 898 dhe 899 të LMD ku pala e paditur përgjigjet për dëmin që ka pësuar i siguruari i tyre. Pra nga vet fakti që baza juridike nuk është kontestuese por lartësia e kompensimit është kontestuar dhe të njëjtën gjykata e ka përcaktuar kryesisht në bazë të mendimit të ekspertve mjeko ligjor dhe të vlerësimit të lirë ku mendimi i ekspertve është vlerësuar si gjithpërfshirës dhe real bazuar në dëmin jomaterial të pësuar dhe i caktuar sipas intensitetit lartësisë, zgjatjen e dhimbjeve të frikës dhe veçanarisht në zvoglimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor pasi që kemi të bëjmë me persona të moshës së re.

Kompensimi i dëmit jomaterial dhe material në të holla ka për qëllim satisfakcionin për të dëmtuarin dhe jo që të arrihet ndonjë qëllim tjetër shoqëror i këtij kompensimi (nuk mund të komercializohen vlerat morale). Lartësinë e dëmit gjykata ka vlerësuar sipas vlerësimit të mjekut ekspert ortoped traumatolog dhe vlerësimit të lirë të gjykatës në kuptim të nenit 200 LMD dhe 33 LPK .

Gjkata e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit në pjesën tjetër të saj, për shkak se, gjatë caktimit të lartësisë së kompensimit ka pasur parasysh lëndimet e marra dhe

qëllimi për të cilën ky kompensim dedikohet dhe ka ardhur në konkludim se vlerat e kërkuara nga ana e të autorizuarit të paditësit si dhe oferta e dhënë nga ana e të autorizuarit të paditurës nuk janë reale, pasi që njëra është tepër e lartë dhe tjetra tepër e ultë. Andaj, vlerësimin e ka bërë në bazë të bindjes së lirë dhe vlerësimit të gjithmbarshëm të gjendjes faktike. Gjithashtu sa i përket ndihmës së personit të tretë dhe ushqimit të përforcuar për të dy paditësat i autorizuari i paditëseve në këtë drejtim e ka tërhequr kërkesën e vet pasi që nuk ka mund të argumentoj shpenzimet e bëra për këto dy elemente të dëmit.

Nga të lartcekurat, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

Shpenzimet e procedurës janë caktuar në bazë të nenit 452.1 LPK duke pasur parasysh se pala e cila ka humbur kontestin duhet të paguajë palës fituese të gjitha shpenzimet të cila janë llogaritur sipas tarifës së avokatëve dhe shpenzimeve gjyqësore.

GJYKATA KOMUNALE NË PRIZREN
C.nr.182/12 të dt.26.11.2012

Gjyqtarja
Shpresa Emra

KËSHILLA JURIDIKE: pala e pakënaqur kundër këtij aktgjykimi ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të kopjes, nëpërmjet kësaj Gjykate Gjykatës së Qarkut në Prizren.